



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

VENDIM

Nr. 65, datë 06.09.2018

PËR LICENCIMIN E SH. A. UJËSJELLËS KANALIZIME KAVAJË

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", si dhe Rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko - Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Kavajë sh.a. për licencim për efekt përfundimit të afatit, Komisioni Kombëtar Rregullator,

Konstatohet se:

- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Kavajë është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 10, datë 16.03.2015 "Për licencimin sh. a Ujësjetllës Kanalizime Kavajë", i ndryshuar.
- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Kavajë ka aplikuar për licencim pranë ERRU me shkresën nr. 1622 prot. datë 04.06.2018 për efekt të përfundimit të afatit.
- Aplikimi i shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Kavajë sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara në Rregulloren e Licencimit për përfundimin e afatit të licencimit, për kategoritë A, B dhe C, konkretisht:
 - Formati i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Për dokumentin Ekstrakt Historik i Regjistrimit Tregtar në të cilin ende nuk janë reflektuar ndryshimet sipas riorganizimit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Kavajë sh.a. bazuar në VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", shoqëria Ujësjetllës Kanalizime

Kavajë detyrohet të paraqesë pranë ERRU ekstraktin e QKB të përditësuar menjëherë pas përfundimit të procesit.

- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Kavajë ende nuk është pajisur me Leje të re Mjedisore për Impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura dhe për këtë arsye nuk mund të licencohet për kategorinë D, "Për trajtimin e ujërave të ndotura".

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a Ujësjetllës Kanalizime Kavajë me:
Drejtues Ligjor Hajrulla Tafa
Drejtues Teknik Sali Vogli
2. Operatori sh.a Ujësjetllës Kanalizime Kavajë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
Kategoria B Për përpunimin e ujit për konsum publik
Kategoria C, Për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Kavajë.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ndriçim SHANI